


# Trustorja

Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës

Rr. Agim Ramadani nr. 10, 10000 Prishtinë; 038 244 341; www.trusti.org; info@trusti.org

## Trusti

### Grafikoni i çmimit të aksionit prej fillimit të vitit



Grafikoni i mësipërm paraqet lëvizjen e çmimit të aksionit për muaj prej fillimit të vitit. Që nga muaji mars i këtij viti, investimet e Trustit kanë treguar rezultate pozitive me kthim mbi 11%.

#### Fakte me rëndësi:

Deri më 30 shtator 2009

Çmimi i njësishë = 0.9559 euro

344.9 milionë euro nën menaxhim

360,800,570.28 aksione të lëshuara

▲ 11.089% - Çmimi i aksionit prej fillimit të vitit

1. Korrik = 4.077%
2. Gusht = 1.771%
3. Shtator = 1.998%


▲ €35.6m - Kthimi në investim prej fillimit të vitit

1. Korrik = 12.485 mil. euro
2. Gusht = 5.929 mil. euro
3. Shtator = 6.879 mil. euro

• Llogari në Trust kanë 286 mijë kontribues

• Gjatë këtij tremujori janë paguar 705 mijë euro benefite

### Alokimi i mjeteve për tremujorin III 2009



Këto janë përqindjet e fondit të investuara nëpër menaxhuesit e mjeteve. Gjatë këtij tremujori janë shitur investimet në FX Concepts dhe Auriel me vendim të Bordit Udhëheqës.

### Performanca e menaxhuesve të mjeteve gjatë tremujorit III 2009

1. VANGUARD	▲ 14.7%	5. Fortis GLF	▲ 0.1%
2. SCHRODERS	▲ 3.2%	6. Raiffeisen Bank	▲ 1.5%
3. ECM-ECL	▲ 17.8%	7. ProCredit Bank	▲ 1.3%
4. ECM-DEC	▲ 23.3%		

Tabela e mësipërme paraqet rezultatet e investimeve në secilin menaxhues të mjeteve. Gjatë këtij tremujori rezultatet më të mira në % i ka pasur ECM-DEC me kthim pozitiv mbi 23%.

Mjetet në llogarinë rrjedhëse në BQK kanë fituar kamatë prej 0.1%.

## Letër nga Angela Burns, anëtare e Bordit Udhëheqës

Të nderuar kontribues,

Si anëtare profesionale e Bordit të Trustit e emëruar rishtazi, jam e kënaqur t'i ndaj me ju, kontribuesit tanë, përshtypjet e mia të punës së deritashme me Trustin dhe vizionin tonë për zhvillimet e ardhshme të Trustit dhe skemës suaj pensional.

Kur iu bashkuam Bordit në prill të këtij viti, unë dhe anëtarët tjerë të rinjë të Bordit jemi njoftuar se mandati i Bordit të kaluar kishte skaduar në shtator të vitit 2008, në një kohë kur kur ekonomia globale dhe veçanërisht sektori i saj financiar provuan një krizë të thellë dhe të gjerë. Mungesa e një Bordi të emëruar gjatë krizës ekonomike, rrjedhimisht mungesa e fuqive ligjore për ta mbrojtur Trustin tuaj në kohë turbullirash, ka nënkuptuar se Bordi i ri ishte i interesuar që ta vlerësojë në mënyrë të qartë se çfarë ndikimi kishte pasur kriza në llogaritë tuaja në Trust, dhe çfarë mund të bëjmë për ta stabilizuar dhe korrigjuar situatën.

Në mbledhjen tonë të parë të mbajtur në maj të këtij viti, Bordi i ri ka vendosur për dy kurse veprimesh: së pari t'i shqyrtojmë investimet të cilat janë bërë deri tash për të vendosur për investime të reja të përshtatshme, dhe së dyti ta vlerësojmë humbjen absolute të kontributeve.

Të përkrahur nga personeli i shkëlqyeshëm ekzekutiv i Trustit, nga Adrian Zalli dhe ekipi i tij, shpejtë kemi qenë në gjendje ta përcaktojmë se strategjitë të cilat janë

aplikuar nga dy prej menaxhuesve të mjeteve, të specializuar në këmbimin e valutave, ishin strategji më të përshtatshme për investime afatshkurtra taktike se sa për profilin e investuesit afatgjatë të fondit tuaj pensional. Prandaj është vendosur të tërhiqen mjetet nga këta dy menaxhues. Ç'prej atëherë Bordi i ri i vlerësuar menaxhuesit potencial të cilët do të ofronin investime që do t'i mbronin llogaritë tuaja nga inflacioni, ose të cilat ofrojnë investime më të sigurta në bono.

Përderisa problemet me të cilat është ballafaquar Trusti gjatë vitit të kaluar në rrafshin e investimeve mund të duken unike për Kosovë, por janë probleme me të cilat janë ballafaquar edhe skemat tjera pensionale kudo nëpër botë. Në përpjekjet tona për t'u përballë në mënyrë efektive me ndikimin e tregjeve sfiduese në llogaritë tuaja individuale, puna e anëtarëve të Bordit ka qenë, deri tash, e ngjashme me secilën përvijë tonën në menaxhimin e skemave tjera përgjatë Evropës. Në vendet tjera, ne, anëtarët profesional të Bordit, po ashtu jemi duke u ballafaquar me rrezikun e investimeve të skemave pensionale, inflacionin potencial në të ardhmen dhe ndikimin i tij në të ardhurat pensionale.

Deri tash përshtypja ime për Trustin është që kjo është një skemë e mirëadministruar pensionale, që i menaxhon në mënyrë efektive mijëra kontribues, si punëdhënës ashtu edhe punonjës, i cili do të rritet gradualisht përgjatë viteve në vazhdim me

zhvillimin e Kosovës dhe rritjen e punësimit dhe të ardhurave. Trustit do ta ketë edhe më të lehtë dhe më të mundshme përmirësimin e administrimit kur të zbatohen përmirësimet e planifikuara të përshtypjetit të dorëzimit të raporteve nga punëdhënësit, që do ta lehtësojë dhe shpejtojë dukshëm barazimin e pagesave të kontributeve me raportet për to. Shpenzimet e shtuara në sistemin e Teknologjisë së Informacionit po ashtu do ta ndihmojnë administrimin efikas të Trustit.

Është kënaqësi të jesh e përfshirë në zhvillimin e një skeme kombëtare pensionale për një vend të ri me popullësi të re dhe në rritje. Në vitet në vazhdim do të kemi mundësi të mira të përmirësimit të skemës, si dhe në rritjen e numrit të punëdhënësve dhe punonjësve pjesëmarrës në skemë, pastaj në kërkimin e mundësisë për t'i ofruar zgjedhje të llojit të investimit kontribuesit, si dhe në informimin gjithëpërfshirës të publikut në Kosovë për përfitimet nga llogaritë e tyre në Trust.

*Angela është këshilltare seniore strategjike për industrinë e menaxhimit të mjeteve dhe atë të sigurimeve në MB dhe Evropë, dhe ka punuar, si partnere e Europa Partners Limited dhe si drejtore e Aktiva Ltd, me një spektër inovativ të menaxhuesve të specializuar të fondeve dhe grupeve të sigurimit të Evropës dhe ShBA-së*

## Kërkohet ulja e taksës menaxhuese

Bordi i Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (Trusti) ka përfunduar sot mbledhjen e dytë të radhës për këtë vit. Kjo është njëkohësisht mbledhja e dytë e Bordit në përbërjen e re, Bordit të parë të Trustit të emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Në këtë mbledhje Bordi Udhëheqës i Trustit ka miratuar buxhetin operacional të Trustit për vitin 2010. Ky buxhet parasheh uljen e shpenzimeve operationale në shumë zëra buxhetorë. Ulja e shpenzimeve operationale reflekton rritjen e efikasitetit të punonjësve në Trust dhe përgjithësisht përmirësimin e dukshëm të administrimit dhe menaxhimit të fondit pensional. Për vitin 2010 pjesa më e madhe e shpenzimeve të

Trustit do të jenë taksat që u paguhen menaxhuesve të mjeteve përmes të cilëve Trusti i investon mjetet e kursimeve pensionale. Këto shpenzime përbëjnë afërsisht 60% të shpenzimeve të gjithmbarshme vjetore të Trustit. Si rrjedhojë e uljes së shpenzimeve, Bordi Udhëheqës i ka propozuar Kuvendit të Republikës së Kosovës ta reduktojë taksën vjetore menaxhuese që Trusti ua ngarkon kontribuesve nga 0.90% në 0.80% të mjeteve, reduktim ky që është propozuar të hyjë në fuqi nga 1 janari i vitit 2010. Sipas Ligjit për Fondin Pensional, caktimi i shkallës së taksës menaxhuese për Trustin ratifikohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

### Investimet

Bordi Udhëheqës shpreh kënaqësinë me rezultatet e investimeve të Trustit që janë shënuar gjatë muajve të fundit të vitit 2009. Që nga marsi i këtij viti investimet e Trustit kanë shënuar kthim pozitiv, kthime këto që kanë rezultuar në rritje prej 8.92% të çmimit të aksionit të Trustit deri në fund të muajit gusht, duke e ngritur kështu çmimin e njësisë në 0.94 euro. Shprehur në vlerë monetare ky kthim pozitiv arrin shumë më shumë prej 47.4 milionë eurove prej kur nisi rimëkëmbja e tregjeve globale. Muaji shtator është po ashtu duke treguar shenja të një kthimi pozitiv. Megjithatë tregjet globale financiare ende nuk e kanë arritur qartësinë e duhur që do të inkurajonte investime më të shumta për një investues konzerativ çfarë është Trusti.